



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2019
ME ZGJEDHJE

Lënda: Qytetari-Psikologji

Model Testi

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **60 pikë**.

Testi ka **20 pyetje** me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përfori përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përfori saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

Qytetari

1. Një prind i papunë i një fëmije me aftësi ndryshe, aplikon për ndihmë ekonomike në bashki.
E drejta që kërkohet në këtë rast lidhet me vlerën: **1 pikë**
- A) morale të ligjit;
B) sociale të ligjit;
C) kulturore të ligjit;
D) politike të ligjit.
2. Identifikoni dy të drejta të njeriut që shprehen në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. **2 pikë**
- _____

- _____

3. Kushtetuta në përmbajtjen e saj është: **1 pikë**
- A) përmbledhje e ligjeve të shoqërisë;
B) informim i qytetarëve për ligjet;
C) tërësi normash në një fushë të caktuar;
D) ligji themeltar i shtetit.
4. Identifikoni dy mënyra të ushtrimit të sovranitetit nga populli. **2 pikë**
- _____

- _____

5. Mira, e cila sot është 21 vjeçe, votoi për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, sepse e drejta e votës në Shqipëri fillon: **1 pikë**
- A) 14 vjeç, sepse nis përgjegjësia penale;
B) 16 vjeç, sepse nis kundravajtja penale;
C) 18 vjeç, sepse është e përcaktuar me ligj;
D) 20 vjeç, sepse mendohet që mbaron adoleshenca.
6. Një i mitur nuk është gjithmonë i pavarur të vendosë për veprimet e tij. Sipas legjisllacionit shqiptar, disa vendime merren nga të rriturit në interes të fëmijës. Juridikisht ndodhemi para: **1 pikë**
- A) paaftësisë për të vepruar;
B) zotësisë së kufizuar për të vepruar;
C) zotësisë së plotë për të vepruar;
D) përgjegjësisë civile.

7. Përshkruani dy kategoritë e mëposhtme të të drejtave të njeriut.

2 pikë

a) Të drejtat civile dhe politike.

b) Të drejtat për mjedisin dhe zhvillimin.

8. Programet lëndore përcaktojnë se çfarë duhet të mësojnë nxënësit në një lëndë dhe shërbejnë si bazë për hartimin e teksteve shkollore. Nxënësve u ofrohen mundësi të barabarta kur programet lëndore hartohen: **1 pikë**

- A) nga vetë shkollat sipas veçorive të tyre;
- B) në nivel qendror, nga organe të specializuara shtetërore;
- C) për çdo qark, nga specialistë të Drejtorive Arsimore;
- D) nga një vend i huaj me përvojë në fushën e arsimit.

9. Listoni dy përgjegjësi të fëmijëve në shkollë.

2 pikë

- ---

- ---

10. Sipas OBSH-së, me termin shëndet duhet të kuptojmë një gjendje të:

1 pikë

- A) aftësisë së individit për të përballuar stresin;
- B) përshtatjes së individit me të tjerët;
- C) mirëqënies fizike, mendore dhe sociale;
- D) mungesës së sëmundjes në trupin e njeriut.

11. Mbrojtja ligjore e shëndetit është e garantuar me ligj. Shpjegoni dy mënyra se si e garanton shteti këtë të drejtë.

2 pikë

- ---

- ---

12. Një mendimtar i njohur ka thënë: "Tokën ne ua kemi marrë hua pasardhësve tanë". Në cilin prej parimeve të ligjit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit konkretizohet kjo shprehje? Analizoni domethënien e këtij parimi.

2 pikë

Parimi:

Analiza:

13. Cila nga alternativat e mëposhtme është një efekt negativ i reklamës?

1 pikë

- A) Diferencimi i produkteve;
- B) Kostoja e fshehur e saj;
- C) Nxitja e blerjeve;
- D) Zgjerimi i rrethit të shitjeve.

14. Supozojmë se ju keni blerë një TV të ri dhe keni marrë fletën e garancisë së tij. Sapo shkoni në shtëpi, vini re se ai nuk po funksionon si duhet. Identifikoni dy elemente nga legjislacioni shqiptar mbi detyrimet e shitësit ndaj konsumatorit, në rastet kur, si në situatën tuaj, malli i blerë nuk shfaq cilësitë e premtuara.

2 pikë

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

15. Sipas ligjit shqiptar, fëmija nga moshë 14 deri në 16 vjeç mund të punësohet gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta. Identifikoni dy nga pasojat që kërkon të parandalojë ky ligj.

2 pikë

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

16. Arta po udhëtonte me makinë me prindërit e saj. Gjatë rrugës asaj i bënë përshtypje sinjalet vertikale rrugore. Prindërit i treguan se këto sinjale kanë:

1 pikë

- A) forma dhe ngjyra të njëjta;
- B) forma të ndryshme dhe ngjyra të njëjta;
- C) forma të njëjta dhe ngjyra të ndryshme;
- D) forma dhe ngjyra të ndryshme.

17. Shkruani dy këshilla që një drejtues i biçikletës duhet të zbatojë për sigurinë vetjake gjatë qarkullimit në rrugë.

2 pikë

- _____
- _____

18. Sipas Kodit etik të medias shqiptare, gazetarët kanë të drejtë:

1 pikë

- A) të botojnë informacionin, ta saktësojnë burimin, por jo të kritikojnë;
- B) të botojnë informacionin dhe më pas të verifikojnë saktësinë e tij;
- C) të marrin informacion, ta botojnë atë dhe të kritikojnë;
- D) të marrin informacion dhe ta botojnë atë edhe nga burime anonime.

19. Shkruani dy tipare të nevojshme që duhet të kenë informacionet për t'u përdorur në rubrikën "lajm".

2 pikë

- _____
- _____

20. Banorët e një pallati janë anëtarë të Asamblesë së Bashkëpronarëve mbi bazën e ligjit "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit". Tashmë bashkëjetesa e tyre do të funksionojë bazuar në:

1 pikë

- A) zakonet shoqërore të kulturës përkatëse;
- B) rregullat dhe normat që përcaktojnë ndërtuesit;
- C) traditat që individët mbarin nga vendbanimet e origjinës;
- D) një tërësi rregullash, normash, ligjesh dhe aktesh nënligjore.

Psikologji

21. Ana nuk ndihej mirë. Zemra i rrihte fort dhe i merrej fryma. Për këtë gjendje emergjence të Anës është përgjegjës: **1 pikë**

- A) seksioni nervor shqisor;
- B) seksioni nervor parasimpatik;
- C) seksioni nervor simpatik;
- D) nervat spinale.

22. Stresi është: **1 pikë**

- A) përshtatje e njeriut ndaj ndodhive të pakëndshme gjatë jetës;
- B) frikë ndaj konflikteve shoqërore të ndryshme;
- C) reagim i organizmit, kur ndaj tij paraqiten kërkesa që duhet t'u përshtatet;
- D) përballimi i frustracioneve që ne përjetojmë në jetën e përditshme.

23. Identifikoni tri shkaqe të stresit. **3 pikë**

- _____
- _____
- _____

24. Disa studiues kërkojnë të zbulojnë se si lidhet faktori *inteligjencë* me faktorin *suksesi në shkollë*. a) Cili lloj kërkimi në studimet psikologjike është më i përshtatshëm të përdoret në këtë rast? **1 pikë**

- _____

b) Identifikoni dy veçori të këtij kërkimi në raport me metodat e tjera. **2 pikë**

- _____
- _____

25. Shpjegoni funksionin që kryen: **3 pikë**

a) truri i prapmë.

b) zona motorike.

c) lobi parietal.

26. Kur njeriu humbet shumë lëngje, ai ka etje. Mesazhi i kësaj gjendjeje shkon në tru. Truri jep sinjal se trupit i nevojitet ujë për të rivendosur gjendjen ideale. Etja që na shtyn të pijmë është një motiv: **1 pikë**

- A) biologjik;
- B) stimulues;
- C) i mësuar;
- D) i kushtëzuar.

27. Sipas Frojdit, e vetmja strukturë psikologjike me të cilën njeriu vjen në jetë është: **1 pikë**
- A) idi;
B) egoja;
C) vetëdija;
D) superegoja.
28. Alesia mendon se një kokërr molle është më pak se dy gjysmat, të cilat e përbëjnë atë. Kjo periudhë e zhvillimit kognitiv quhet: **1 pikë**
- A) sensorimotore;
B) paraoperacionale;
C) konkretoperacionale;
D) formaloperacionale.
29. Shpjegoni qëndrimet mbi personalitetin sipas teorisë humaniste. **3 pikë**
- _____

 - _____

 - _____

30. Sipas Gordon Ollport tiparet që i japin drejtim gjithë jetës së njeriut janë tiparet: **1 pikë**
- A) themelore;
B) parësore;
C) dytësore;
D) e ngrrohta.
31. Një cikël i plotë gjumi zgjat rreth 90 minuta. Njeriu kalon në disa cikle të tilla gjumi gjatë natës. Gjatë pjesës së parë të saj njeriu kalon më shumë kohë në: **1 pikë**
- A) gjumin me LSHS;
B) etapën e parë të gjumit me LJSHS;
C) etapën e dytë të gjumit me LJSHS;
D) etapën e tretë dhe të katërt të gjumit me LJSHS.
32. Cili nga pohimet e mëposhtme që lidhet me ndërgjegjen është **i gabuar**? **1 pikë**
- A) Vetëdija e ndjimeve dhe mendimeve në kohën që jemi zgjuar, quhet ndërgjegje e gjendjes së zgjimit.
B) Gjendjet e ndërgjegjes së ndryshuar shfaqen kur ka më tepër një zhvendosje cilësore sesa thjesht një zhvendosje sasiore të proceseve mendore.
C) Gjendjet e ndërgjegjes së ndryshuar shkaktohen nga mosfunksionimi i procesit të vëmendjes.
D) Në sajë të ndërgjegjes ne kemi aftësinë të mendojmë, kujtojmë dhe arsyetojmë.

- 33.** Beni ishte ulur në një park dhe po shihte fëmijët që po luanin. Papritur atij filluan t'i shfaqeshin imazhe të fëmijërisë së tij teksa luante me shokët dhe shoqet.
- a) Cila kujtesë i kishte shërbyer Benit për këtë gjë? **1 pikë**
- _____
- b) Identifikoni tre përbërës bazë të kujtesës. **3 pikë**
- _____
 - _____
 - _____
- 34.** Bindja është: **1 pikë**
- A) të menduarit e thellë;
B) zbatimi i urdhrave të dhëna;
C) sjellja sipas dëshirës së grupit;
D) dorëzimi para kërkesave të të tjerëve.
- 35.** Pohimi se sjellja jonormale është pasojë e konflikteve të brendshme, i përket shpjegimit: **1 pikë**
- A) biologjik;
B) psikoanalitik;
C) kognitiv;
D) humanist.
- 36.**
- a) Çfarë janë qëndrimet në psikologji? **1 pikë**
- _____
- _____
- _____
- b) Analizoni tre faktorë që ndikojnë në formimin e qëndrimeve tona. **3 pikë**
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____